



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI UNIVERSITARE / PASUNIVERSITARE NË UKRAINË,  
VITI AKADEMIK 2020-2021**

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Ukrainës për vitin akademik 2020-2021 ofron 5 (pesë) bursa për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet universitare në programe studimi Bachelor/ ose pasuniversitare në programe studimi Master (me kohë të plotë) në Universitetet Publike të Ukrainës.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të plotësojnë kriteret sipas *aneksit 1* (bashkëlidhur) si dhe të plotësojnë formularin që gjendet në *aneksin 2* (bashkëlidhur):

Studimet akademike zhvillohen në gjuhën ukrainase dhe të gjithë kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të ndjekin kursin përgatitor në gjuhën ukrainase për vitin akademik 2020-2021.

Modalitetet lidhur me mbulimin e shpenzimeve përcaktohen pasi kandidatët të jenë pranuar nga universitetet përkatëse të Ukrainës për ndjekjen e studimeve në bazë të kualifikimit që ata zotërojnë.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (nëpërmjet postës) deri në datën 13 mars 2020 (afati i fundit) dokumentet sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Ukrainës. Dokumentacioni duhet të shoqërohet me kërkesën e firmosur nga kandidati drejtuar MASR (ku të jepet një adresë kontakti e-maili dhe numër telefoni), duke specifikuar fushën e studimit. Dokumentet duhet të noterizohen dhe të përkthehen në gjuhën angleze.

Sqarojmë se me postë duhet të dërgohen vetëm kopjet e noterizuara të dokumentacionit të kërkuar me qëllim verifikimin e autenticitetit të tyre. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë rezervon të drejtën e verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar të panoterizuar me institucionet lëshuese të dokumentit.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të programeve të studimit, si dhe informacione të tjera gjenden bashkëlidhur këtij njoftimi.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**